



Бр./Nr _____

_____ р./в.

Në bazë të nenit 22 paragrafi 1 nga Ligji për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë " Nr. 12/2019) neni 40 paragrafi 2 nga Rregullorja për punë të Komisionit Shtetërorë për Parandalimin e Korrupsionit, duke vepruar sipas denoncimit të parashtruar nga parashtrues të njohur KSHPK (në tekstin e mëtejshëm) në vazhdimin e seancës së 54-të, të mbajtur më 02.11.2021, morri vendimin vijues:

VENDIM

Denoncimi i regjistruar sipas numrit 09-646/1 të 29.02.2020, Refuzohet.

KSHPK-ja përcaktoi se sipas Ligjit për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesit nuk ka elemente për veprim kompetent sepse për të njëjtën ngjarje kanë vepruar organet tjera kompetente.

Lënda me numër 09-646/1 të datës 29.01.2020 të mbyllet dhe të arkivohet .

Vendimi i KSHPK-së, me arsyetim - në formë të depersonalizuar, të publikohet në ueb - faqen e KSHPK-së brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e vendimmarrjes.

Arsyetim

Lënda me numër 09-646/1 nga 29.01.2020 është formuar me kërkesë të /// /// /// me të cilën kërkohet të iniciohet procedurë për parandalimin e konfliktit të interesit nga veprimet e kryera nga ///. /// /// ///. /// Rektor i ///. Personat e përmendur në takimin e zhvilluar me ish-ministrin /// ///, janë pajtuar për nënshkrimin e marrëveshjeve kolektive në nivel të punëdhënësve me përmbajtje të paracaktuar, pas së cilës rektorët e universiteteve të përmendura kanë dhënë udhëzime për dekanët e fakulteteve dhe të drejtorëve të institucioneve për të krijuar sindikatë, gjatë së cilës pas indikacioneve dhe njohjes së tyre, ishte dërguar fletë aderimi në një sindikatë që nuk ekziston . Me veprimet e mësipërme, personat e kallëzuar si persona përgjegjës në institucionet e tyre kanë shkelur nenin 67 të Ligjit për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesit.

Po ashtu, me datë 12.02.2020, nga të njëjtit parashtrues është dorëzuar njoftim plotësues se Inspektorati Shtetëror i Punës ka vepruar sipas denoncimit të njëjtë të dorëzuar tek ata dhe është konstatuar kundërligjshmëria e aktiviteteve të ndërmarra, përkatësisht është konstatuar shkelje e nenit 195 të Ligjit të Punës, ndërsa aktivitete për formimin e një sindikate të re ndërpriten.

Me njoftimin e dorëzuar për veprimin e KSHPK-së në përputhje me kompetencat e saj, dhe konstatimi i shkeljes së Ligjit të Punës, Komisioni Shtetëror nuk ka elemente për veprime të mëtejshme për çka ka vendosur si në dispozitën e këtij vendimi.

**КОМИСИОН ШТЕТЁРОР
ПЁР ПАРАНДАЛИМИН Е КОРРУПСИОНИТ**
Крyетар,
Билјана Ивановска

Pas përfundimit të seancës së KSHPK-së
Punoi:
S.M, bashkëpunëtor i lartë
Miratoi:
NB, anëtar i KSHPK - së

